

# Llogaria Futura

## Informacion rreth Bankës

### Intesa Sanpaolo Bank Albania

Drejtoria Qendrore: Rr" Ismail Qemali, Nr. 27,  
Kutia postare 8319  
1001 Tirane, Shqipëri  
Tel: +355 4 22 76 000; Fax +355 4 22 48 762  
Website: www.intesaspaolobank.al

## Karakteristikat dhe rreziqet e Llogarisë Futura

### Karakteristikat e Llogarisë Futura

Llogaria FUTURA është një investim afat-gjatë, e cili hapet në emrin e fëmijës nga momenti i lindjes. Paratë mund të depozitohet në llogari në çdo kohë dhe pa limit deri sa fëmija të mbush 18 vjeç. Shuma minimale për të hapur një depozitë Futura është LEK 10.000; EUR/USD100.

Kur fëmija mbush 18 vjeç, kjo llogari do të kthehet në një llogari kursimi të zakonshme dhe ai/ajo do të veprojë si firma e vetme e autorizuar në këtë llogari.

Banka njofton nëpërmjet telefonit fëmijën në ditën që ai fiton zotësinë e tij për të vepruar në llogarinë ekzistuese Futura.

Interesi kreditohet në llogari një herë në vit, çdo datë 31 Mars.

Vetëm prindërit (të dy në të njëjtën kohë) ose përfaqësuesi ligjor ka të drejtë të hap dhe thyej llogarinë Futura duke u paraqitur në mjediset e bankës. Gjatë kohëzgjatjes së produktit Futura nëse prindërit e fëmijës do të divorcohen, vetëm përfaqësuesi ligjor me vendim gjykatë gëzon të drejtën që të përdor llogarinë Futura. Gjatë kohëzgjatjes së Llogarisë Futura, nëse prindërit dëshirojnë të ndryshojnë monedhën e llogarisë ose të hapin llogari të tjera në monedhë tjetër, ata janë të lirë të veprojnë kundrejt asnjë penaliteti. Në datën e maturimit të Llogarisë Futura fëmija (titullari i llogarisë) duhet të paraqitet në ambientet e bankës për të kryer procedurat operacionale për mbylljen / likuidimin e Llogarisë Futura ose për transferimin e shumës në një llogari tjetër të zgjedhur prej tij/saj (duke përjashtuar rastet kur në Bankë do të paraqitet një urdhër gjykatë i zbatueshëm ose një dokument me shkrim në bazë të ligjit i cili vërteton se titullari nuk ka zotësi për të vepruar dhe/ose nuk ka aftësinë për të vepruar).

### Tregu i synuar

Produkti ofrohet për të gjithë klientët individë, moshë e fëmijëve të të cilëve fillon nga data e lindjes deri në moshën 15 vjeç. Fëmijët që janë 15 vjeç nuk janë subjekt i këtij produkti.

### Dokumentet e nevojshme

Pasaportë ose Kartë identiteti të prindërve ose përfaqësuesit ligjor  
Certifikatë lindje ose pasaportë të fëmijës për të cilin hapet llogaria

- Certifikata familjare
- Kërkesa për Formularin e Aplikimit për Llogarinë Futura
- Kontrata për Llogarinë Futura
- Dokumentacioni i FATCA

### Shërbime Suplementare

Shërbimet të cilat ofrohen me Llogarinë Futura përfshijnë Depozitat Cash, Transfertat Urdhër pagesa periodike – nëse prindi ka një llogari rrjedhëse dhe dëshiron të kryej transfertat automatike në mënyrë periodike.

### Rreziqet e Llogarisë Futura

1. Kompensimi i depozitave bazohet në nenin 33, paragrafi 1, pika a) e Ligjit nr. 53/2014, datë 22/05/2014 "Për sigurimin e depozitave", në bazë të të cilit ASD siguron dhe kompenson depozitat e çdo depozituesi në Bankë ose në degën e bankës së huaj deri në masën 100 përqind, por në çdo rast jo më shumë se Lek 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë), pavarësisht nga numri i depozitave dhe monedha e tyre, që janë depozituar në Bankë.

2. Në rast se llogaria rrjedhëse është në një monedhë të ndryshme nga monedha e të ardhurave, ekziston rreziku i luhatjes së normës së interesit.

3. Një tjetër rrezik që lidhet me këtë produkt është që, urdhër pagesa periodike nuk do të kryhet nëse nuk ka fonde të mjaftueshme në llogarinë rrjedhëse të klientit.

## Kushtet kryesore ekonomike

Lista e të gjitha kostove dhe shpenzimeve të produktit:

#### Normat e Interesit

LEK	1.450 %
EUR	0.300 %
USD	0.450 %

#### Komision Mirëmbajtje

Komision i mirëmbajtjes së llogarisë* ALL/EUR/USD/GBP	Falas
--	-------

\*Të lutem referoju pikës 2 në seksionin e "Rreziqet e Depozitës me Afat"

#### Tatim i mbajtur në burim

Tatimi në burim aplikohet sipas ligjit shqiptar i pagueshëm në momentin e përfitimit të interesit	15% e interesit të përfituar
---	------------------------------

#### Kosto të tjera të lidhura me llogarinë

Lëvizjet e Aktivitetit të Llogarisë	Falas
Rritja e shumës së depozitimeve	Falas
Ulja e shumës së depozitimeve	Jo e aplikueshme
Lëshimi i konfirmimit bankar	1000 Lek (Opsionale, sipas kërkesës së klientit)

#### Likuidimi i interesit

Shuma	100,000.00 LEK
Interesi Bruto	246.58 LEK
Taksa	36.99 LEK
Interesi Neto	209.59 LEK
Periodiciteti i interesit dhe pagesës së taksave	Një herë në vit (në 31 Mars të çdo viti)
Data e likuidimit të interesit	04/11/2016

## Tërheqja para afatit, ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore dhe ankesat

### Tërheqja nga Kontrata

**Tërheqja e pjesshme:** Nuk lejohet

**Likuidimi i parakohshëm:** Lejohet (Shuma e plotë)

1. Në rastin e likuidimit të parakohshëm të Llogarisë Futura, klienti do të përfitojë:

- shumën e principalit që ka investuar në momentin e thyerjes së depozitës
- interesi që paguhet/likuidohet nuk përfshin interesin e 3 (tre) viteve të fundit kalendarike ose pjesën (interesin e llogaritur për vitin aktual). Kjo konsiderohet si penalitet për likuidimin e parakohshëm

2. Në rastin e likuidimit të parakohshëm, Llogaria Futura do të mbyllet vetëm me kërkesë të të dy prindërve ose përfaqësuesit ligjor.

- Deri në EUR 10,000 dhe shumën ekuivalente në LEK/USD, vendimi i gjykatës nuk është i nevojshëm
- Mbi EUR 10,000 dhe shumën ekuivalente në LEK/USD, duhet vendimi i gjykatës

### Dokumentet që duhet për mbylljen e parakohshme:

Vendim gjykate (në varësi të shumës siç përshkruhet më sipër), Pasaportë ose Kartë Identiteti të prindërve ose përfaqësuesit ligjor, Certifikatë familjare, certifikatë lindje ose pasaportë e fëmijës për të cilin është hapur llogaria

### Dokumentet që duhen për mbylljen e llogarisë

Pasaportë ose Kartë identiteti e fëmijës dhe Certifikatë Familjare

### Ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore

Çdo ndryshim i kushteve, i cili përcaktohet në mënyrë të shprehur në kontratën e llogarisë, do të jetë efektiv pas dakordësisë me shkrim të palëve. Asnjë ndryshim i kushteve të përcaktuara shprehimisht në kontratën e llogarisë nuk do të jetë efektiv nëse nuk janë dakordësuar me shkrim midis palëve.

### Ankesat

Ankesat do të paraqiten në bankë duke përdorur një nga format e mëposhtme:

- Në formë shkresore përmes postës zyrtare të bankës;
- Në "Kutinë e ankesave & sugjerimeve" që ndodhet në degë (Ju dëgjojmë 100%);

- Ankesa me shkrim të cilat dërgohen nëpërmjet faqes të internetit të bankës në adresën zyrtare të email-it: [complain@intesasanpaolobank.al](mailto:complain@intesasanpaolobank.al)
- Në Qendrën e Kontaktit : 08006000

Koha e kthimit të përgjigjes nga ana e Bankës është maksimumi brenda 30 ditë nga data e marrjes së ankesës.

## Fjalorthi i Termave Kryesore

**ASD-** Agjencia e Sigurimit të Depozitave (Agjencia) është person juridik publik, me seli në Tiranë, e cila ushtron funksionet e saj, me qëllim përmbushjen e objektivave në zbatim të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014, "Për Sigurimin e Depozitave".

**Interesi Neto-** vlera bruto e interesit minus tatimin në burim

**Tatimi ne burim** - është një kërkesë e qeverisë për pagesin për një të ardhur të tatueshme në burim ose tatimin e zbritshëm nga pagesa në favor te qeverisë .Ky tatim aplikohet më së shumti në të ardhurat nga puna , pagesa interesash ose dividendë.

**Penalitet-** Vlera e interesit e gjeneruar por jo e përfituar prej klientit